Nr. 5035
18.11.19

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR**
**KORCE**

Korçë, me 07.11.2019

## SHPALLJE VENDIMI

Ne kendin e afishimit te shpalljes prane Njesise Administrative Libonik, Bashkia Maliq.

Per: Shtetasin Kastriot Kupe
Me adrese: Fshati Vlocisht, Njesia Administrative Libonik, Bashkia Maliq.

Bashkalidhur po ju dergojme shpalljen për vendimin nr. 1214, dt. 22.10.2019 per t'u afishuar nga ana e juaj njoftimi me shpallje *(20 ditore) dhe me pas 5 dite afat ankimi* – pasi deftesa e komunikimit eshte kthyer me shenimin se ky shtetas eshte larguar ne Australi dhe pas afishimit kjo shpallje te na kthehet e konfirmuar me vule e firme, ne gjykate.

KANCELARE
Lubiana KINOLLI

U afishua sot ne dt____________________
Nenpunesi_________________________
(emer, mbiemer, firme)

- Nj. Ad. Libonik
- Drj. Inf. Publik

18.11.2019

Nr. 112 Prot
Dt. 19.11.19

Shpenzimet gjyqesore te parapaguara nga pala paditese Bashkia Korçe lihen ne ngarkim te saj.

- Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Korçë, brenda 5 (pese) diteve duke filluar nga dita e neserme e komunikimit te vendimit te arsyetuar.

U shpall ne Korçë, sot më datë 22.10.2019 .

**SEKRETARE**
**Erina ZORBA**

**GJYQTAR**
**Arben LERA**

*(sipas Flete-Thirrjes dt. 04.10.2019 te derguar nga Gjykata e cila rezulton te jete nenshkruar prej Bashkise Korçe).*
Rezulton se ne sekretarine e gjykates nga pala paditese Bashkia Korce eshte paraqitur shkresa nr. 9462 prot dt.14.10.2019 me objekt: *Heqje dore nga gjykimi i padise*, ku deklarohet se *meqenese vlera qe kerkohet te paguhet nga ana e pales se paditur eshte likujduar i bejme me dije gjykates se heqim dore nga gjykimi i padise.*

Nga gjykata eshte qendruar ne pritje brenda nje afati te arsyeshem ne sallen e planifikuar per zhvillimin e gjykimit duke e perseritur vazhdimisht thirjen per paraqitjen e paleve.

Nga pala paditese nuk rezulton te jete bere me dije per gjykaten ndonje shkak i perligjur lidhur me kete mosparaqitje, sikurse nuk rezultoi te jete depozituar ne sekretarine gjyqesore ndonje kerkese per shtyrje te gjykimit apo per te justifikuar mungesen e saj ne gjykim.

Ne keto kushte, referuar nenit 299/c te K.Pr.Civile ku citohet se: " *Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur....*c) *Pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht ne ligj.*
Gjykata çmon se duhet vendosur pushimi i gjykimit, pasi jemi perpara rasteve te parashikuara nga neni 179/2 te K.Pr.Civile ku citohet se: "*Nëse paditësi, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit, kur i padituri nuk ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes. Kur i padituri e ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes, mund të kërkojë vijimin e gjykimit në mungesë të paditësit dhe gjykata, kur vlerëson se qëndrimi i të paditurit ka shkak të ligjshëm, vijon gjykimin në mungesë të paditësit*".

***Perfundimisht ne kushtet kur rezulton qe paditesi pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk u paraqit ne gjykim dhe rezulton te kete mare dijeni rregullisht dhe te paditurit nuk kane dorëzuar deklaratën e mbrojtjes, Gjykata bazuar ne kriteret e dispozites se sipercituar ka detyrimin ligjor qe te disponoje me vendim per pushimin e gjykimit te çeshtjes.***

Persa i perket shpenzimeve gjyqesore qe rezultojne te jene kryer ne lidhje me tarifen mbi aktet dhe ato te njoftimit te paleve te parapaguara nga pala paditese, ne kushtet e pushimit te çeshtjes çmohet qe ato duhet te lihen ne ngarkim te kesaj pale, pra siç jane kryer.

## PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenet 179 dhe 299/c te K.Pr.Civile

## VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit te çeshtjes civile me Nr.regj.them 21235-01632-41-2019 (1464), Dt. regj 25.09.2019 me pale ndergjyqese: Paditës Bashkia Korçe, te paditur Kastriot Kupe dhe Vangjel Kupe, me objekt: "Permbushje detyrimi kontraktor, qe rrjedh nga konstrata e qirase e dates 18.09.2012 ne masen 55.988 (pesedhjete e pese mije e neteqind e tetedhjete e tete) leke, qe perfaqeson vleren e papaguar te qirase.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
KORÇË

**Nr.Regj.Them.21235-01632-41-2019 (1464)** **Nr.Vendimi 41-2019-3687 (1214)**
**Dt.Regj 25.09.2019** **Dt.Vendimi 22.10.2019**

**VENDIM**
**"NE EMER TE REPUBLIKES"**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korce e perbere nga
**GJYQTAR: ARBEN LERA**

Asistuar nga sekretare gjyqesore Erina Zorba, ne Korçe sot me daten 22.10.2019, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura çeshtjen civile me Nr.regj.them. 21235-01632-41-2019 (1464), Dt. regj 25.09.2019qe i perket:

**PADITËS: Bashkia Korçe,** perfaqesuar nga Kryetari i saj, z. Sotiraq Filo, me dijeni me mungese.

**TË PADITUR: 1. Kastriot Kupe,** banues ne fshatin Vloçisht, Njesia Administrative Libonik, Bashkia Maliq, me dijeni ne mungese.
**2. Vangjel Kupe**, banues ne Voskopoje, Njesia Administrative Voskopoje, ne mungese.

**OBJEKTI:** Permbushje detyrimi kontraktor, qe rrjedh nga kontrata e qirase e dates 18.09.2012 ne masen 55.988 (pesedhjete e pese mije e neteqind e tetedhjete e tete) leke, qe perfaqeson vleren e papaguar te qirase.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 32, 32 i K.Pr.Civile, neni 455 e vijues, neni 801 e vijues i K.Civil.

**PARASHTRON:**

Me kerkesepadine depozituar ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Korçe pala paditese Bashkia Korçe, duke thirrur ne gjykim si te paditur shtetasit Kastriot Kupe dhe Vangjel Kupe ka kerkuar permbushjen e detyrimit kontraktor, qe rrjedh nga kontrata e qirase e dates 18.09.2012 ne masen 55.988 (pesedhjete e pese mije e neteqind e tetedhjete e tete) leke, qe perfaqeson vleren e papaguar te qirase, bazuar ne nenet 32, 32 i K.Pr.Civile, neni 455 e vijues, neni 801 e vijues i K.Civil.

Pas njoftimit te kerkesepadise dhe akteve shoqeruese, Gjykata bazuar ne nenin 158/c te K.Pr.Civile ka disponuar me urdher per caktimin e seances gjyqesore.

Ne seancen gjyqesore te dt. 22.10.2019 gjykata konstatoi se pala paditese nuk eshte paraqitur ndonese kishte marre dijeni rregullisht lidhur me zhvillimin e gjykimit